



Nr./Br.No. 01/002/23 Nr./fq/Br.str./Nr.pg. 8  
 Data/Datum/Date 03.02.2023  
 PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS  
SINDIKAT KOSOVSKA POLICIJA  
KOSOVO POLICE UNION



REFERENCE:	SPK-01/002/23	DATË:03.02.2023
PËR/ZA/TO:	z. Naim QELAJ Avokat i Popullit	
CC:	z. Fehmi Hoti U.D.Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtëpërdrejtë	
NGA/OD/FROM:	z.Imer Zeqiri Kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për iniciativë kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik	



Inderuar Avokat i Popullit z. QELAJ,

Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i shpallur në gazetën zyrtare me 5 Janar 2023 vlerësojmë se është e nevojshme të kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë sipas vlerësimit tonë në disa pjesë që kanë të bëjnë me personelin policor. Ne kërkojmë nga Institucioni i Avokatit të Popullit që sipas kompetencave tuaja kushtetuese dhe ligjore, t'a procedoni në Gjykatën Kushtetuese Ligjin NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik për vlerësim të kushtetutshmërisë.

Nga këndvështrimi jonë ne mendojmë se ky Ligj me disa dispozita në raport me të punësuarit në Polici cenon parimin e barazisë dhe mos-diskriminimit si dhe parimin e ligjshmërisë mbi bazën në të cilën është hartuar.

Ne në vazhdimësi kemi dërguar komentet gjatë kohës së hartimit të Projektligjit, komente të cilat janë dhënë mbështetur në analizat dhe diskutimet e brendshme të zhvilluara paraprakisht por që komentet dhe vërejtjet tona janë marrë në konsideratë pjesërisht. Disa nga komentet tona mendojmë se ka hapësirë të trajtohen edhe nga aspekti i vlerësimit të kushtetutshmërisë së këtij ligji prandaj kërkojmë që në rrugë institucionale të njëjtat të trajtohen nga ju dhe më pastaj sipas vlerësimit tuaj të procedohen tutje në Gjykatën Kushtetuese.

Ne konsiderojmë se Policia është institucion i cili ka specifikat e sajë të punës, kompleksitetin e detyrave dha autorizimeve policore dhe në veçanti si institucion i zbatimit të Ligjit dhe Sigurisë i paraparë edhe me Kushtetutën e Kosovës prandaj edhe trajtimi i personelit policorë në kuadër të Ligjit duhet të jetë mbi bazën e parimit të barazisë dhe mos diskriminimit.

Ndonëse në këtë fazë nuk dihen ndarjet e shtesave të cilat parashihen me akte nënligjore është e vështirë të bëhet kalkulimi dhe analiza e mirëfilltë e efektit të dispozitave megjithatë në vazhdim gjeni disa nga

vërejtjet tona sa i përket trajtimit të personelit policor që kanë të bëjnë me: kushtet specifike të punës; kompensimet mbi pagën bazë dhe kategorizimi në kuadër të shtojcave të ligjit në lidhje me grupe dhe klasën si dhe trajtimi i disa funksioneve mbështetëse unike të Policisë së Kosovës.

Më konkretisht :

- Nenin 26 sa i përket shtesave për Kushtet Specifike të punës - rrezikshmërisë ;
- Nenin 35 dhe 36 Kompensimet; Kompensimi për kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës dhe
- Nenin 44 Shtojcat e ligjit, Shtoja Nr.5.1. – Policia e Kosovës;
- Shtoja Nr. 10.6. - e Projektligjit - nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësi i administratës së shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës

#### I. NENI 26 SHTESA PËR KUSHTE SPECIFIKE TË PUNË (shtesa e rrezikshmërisë):

Kjo shtesë në bazë të Ligjit për Paga nënkuption shtesën e rrezikshmërisë e cila është e aplikueshme edhe për personelin policor krahas edhe institucioneve tjera. Përcaktimi se cilat institucionë respektivisht pozita do të përfitojnë këtë shtesë nuk është saktësuar me Ligj por është përcaktuar te rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

Në Paragrafin 2 të nenit 26, Ligji përcakton vlerën shtesës e cila nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdoruar nga organizata buxhetore për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëtin vit finanziar. Në kuptim të organizatës Buxhetore, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. Nga ky rregullim juridik shihet se nuk garanton siguri juridike se në çfarë shume do të ketë mundësi të përfitojë Policia nga kjo ndarje dhe se do të ketë mundësi të kemi një trajtim të drejtë në raport me rrezikun për jetën dhe shëndetin, ligji këtë e ka përcaktuar të rregullohet me akt nënligjor.

Për informacionin tuaj sipas kalkulimeve tona, gjatë vitit 2022 në PK për rrezikshmëri janë ndarë rrith 15,6 milion euro ndërsa në bazë të Ligjit për Paga kjo shumë do të jetë shumë më e vogël dhe për më shumë kjo zbritje e kësaj shtese nuk ka shpjegim ligjor.

Më konkretisht Buxheti i Kosovës për vitin 2023, Tabela 2 Përbledhje e ndarjeve buxhetore në kategorinë e pagave dhe shtesave është paraparë të jetë 745,528,136 euro. Nga parashikimi i përcaktuar me Ligjin për ndarjet buxhetore nuk mundemi ta dimë sa është buxheti vetëm për pagën bazë ashtu siç parashesh në llogaritjen e Ligjit për paga. Nëse buxheti i Kosovës si tërsi për kategorinë e pagave dhe shtesave, llogaritet sipas Ligjit për paga tek shtesa për kushte specifike (me llogaritje 1%) nënkuption se rrith 7.4 milion euro do të jenë të dedikuara për rrezikshmëri. Kjo shumë është akoma më e vogël nëse ky kalkulim bëhet vetëm mbi pagën bazë.

Për më shumë Ligji për paga nuk saktëson se në çfarë përqindje shuma e dedikuar për shtesën e rrezikshmërisë do t'i ndahet Policisë së Kosovës, sepse shuma prej 1% është paraparë për të gjitha institucionet e Kosovës. Kjo nuk garanton një siguri juridike të trajtimit me ligj të një të drejtë të të punësuarve siç është kompensimi për jetën dhe shëndetin. Siç shihet kjo shtesë do të jetë shumë simbolike në raport me rrezikimin e jetës dhe shëndetit të zyrtarëve të PK-së si dhe do të ndikojë negativisht në të ardhurat neto të zyrtarëve në disa kategori. Në kuadër të Policisë janë 8704 personel policor dhe në kuadër të këtij numri 7792 janë zyrtarë të uniformuar. Nëse kjo shumë ndahet tek të gjithë zyrtarët e uniformuar në mënyrë të barabartë i bie se për pagën bazë të zyrtarit Policor të Lartë mund të jetë rrith 10% e pagës në muaj (kjo llogaritje nuk mund të jetë e saktë pa ditur sakt ndarjen e kësaj shtese për Policinë). Kjo është një shumë e ulët dhe e padrejtë në raport me rrezikun për jetën dhe shëndetin.

Momentalisht shtesa me ulët e rrezikshmërisë në Policinë e Kosovës është me e madhe se 30% deri përafërsisht 50 % të pagës bazë të zyrtarit policor varësisht nga njësiti çfarë niveli të rrezikshmërisë ka.

Ndonëse është vështirë e krahasueshme kjo shtesë me shtesat të cilat jepen për pozita tjera megjithatë, konsiderojmë se gjatë hartimit të ligjit janë përdorur standarde të ndryshme tek përcaktimi i shtesave. Kjo përfaktin se në disa raste kalkulimi i shtesave bëhet me përqindje mbi pagën bazë e në raste tjera në bazë të përqindjes në buxhetin e shtetit dhe në raste tjera me përqindje në buxhetin e organizatës. Ky dallim sipas nesh paraqet cenim të drejtave të trajtimit të barabartë dhe kjo në raport me Policinë është pasqyrë e trajtimit të kësaj shtese.

Dallimet që ndërlidhen me arsyet e dhëna më lartë janë në shembujt në vazhdim:

- Neni 8 paragrafi 1. “*Funksionarja/i publike, zyrtarja/i publike, zyrtaret/ët e/i tjera/ë, si dhe stafi akademik universitar që marrin pagën bazë sipas shtojcave të këtij ligji, nëse angazhohen me punë në një institucion tjetër publik, kur këtë e lejon ligji i veçantë, marrin pagesë, si pagë deri në njëzet për qind (20%) të pagës bazë për angazhimin në atë institucion.”*
- Neni 12 paragrafi 1. “*Anëtaret/ët e organeve drejtuese, (këshilla, borde, komisione) kolegiale, të institucioneve kushtetuese, të agjencive të pavarura dhe të institucioneve të sistemit të drejtësisë, të krijuara me ligj që nuk e ushtrojnë mandatin me kohë të plotë dhe nuk përmenden shprehimisht në Shtojcën Nr.1 të këtij ligji, shpërblehen në masën njëzet për qind (20%) të pagës së kryetares/ it të organit kolegjal me kohë të plotë”* dhe paragrafi 2 i të njëjtit nen “*Në rastin kur edhe krytarja/i e/i organit drejtues është me kohë të pjesëshme, atëherë shpërblimi si dhe shpërblimi i anëtareve/ëve të organit drejtues, bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtaret/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit”.*
- Neni 23 , shtesa e paraparë për deputet/ët paragrafi 2” *shtesa e veçantë për pjesëmarrje në të gjitha komisionet nuk mund të kalojë tridhjetë për qind (30%) të pagës bazë së deputetit. paragrafi 2. Shtesa e veçantë për pjesëmarrje në të gjitha komisionet nuk mund të kalojë tridhjetë për qind (30%) të pagës bazë së deputetit”* dhe paragrafi 4 i të njëjtit nen “*Anëtaret/ët e Kuvendit Komunal për pjesëmarrje në komitetet e përhershme, mund të marrin një shtesë të posaçme prej tridhjetë përqindë (30%) të pagës bazë të përcaktuar për anëtaren/ in e Kuvendit”*
- Neni 27, Shtesa për punën pa orar të paracaktuar paragrafi 1 “*Përveç pagës bazë, zyrtarja/i politik e/i kabinetit që nuk ka orar të paracaktuar të punës mund të përfitojë një shtesë të posaçme, e cila nuk mund të kalojë tridhjetë për qind (30%) të pagës bazë”* etj.

Këto rregullime mendojmë se janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 24 (barazia para ligjit) edhe përfaktin se nuk janë në mënyrë uniforme të llogaritura në raport me shtesat tjera por edhe në raport me vlerën apo arsyen për të cilën jepen shtesat.

Nëse krahasohen natyra e punës së zyrtarëve me shtesat e prezantuara më lartë në raport me shtesën për kushte specifike të punës ( rrezikshmërinë) është një trajtim jo i drejtë. Kjo përfaktin se natyra e punës për të cilën është paraparë kjo shtesë nuk është në proporcione me rreziku për jetën dhe shëndetin. Zyrtarit Policor të Lartë në bazë të analizës së Ligjit shtesa e rrezikshmërisë mund të jetë rrëth 10% e pagës në muaj. Ky kalkulum do të jetë më i saktë pas përcaktimit të shumave me aktin nënligjor për këtë shtesë dhe deri atëherë është e pasigurtë se sa do të jetë vlera e shtesës apo përqindja në raport me personin respektivisht të punësuarin.

Për të ilustruar më detajisht për çfarë arsyet është përcaktuar kjo shtesë flasin të dhënat tonë se deri me tani në kryerje të detyrës kanë humbur jetën 22 zyrtarë policor, kanë vdekur në detyrë 322 zyrtarë, 426 zyrtarë policor janë lënduar në kryerjen e detyrave zyrtare, 237 zyrtarë të sëmurë në detyrë,

aktualisht me sëmundje të veçanta shëndetësore janë 528 zyrtarë. Deri tani kemi 2250 zyrtare policor të cilët kanë dhënë dorëheqje vullnetare nga Policia.

Ky përcaktim juridik i kësaj shtese mendojmë se nuk është kompleksiteti i punës së policisë, specifikat e punës, kushtet në të cilat punojnë, ekspertiza që kërkohet dhe rrezikshmëria në të cilën punojnë personeli policor. Pasur parasysh kushtet dhe ambientin e punës Policia e Kosovës është ndër institucionet me rrezikshmërinë më të lartë në shoqëri si nga aspekti i shëndetit ashtu edhe nga aspekti i rrezikut për jetë. Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore përballet me rreziqe të drejtpërdrejta për jetën dhe shëndetin si dhe situata stresuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë policore. Zyrtarët policor kanë autorizim të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të rrezikshme gjithashtu për jetën dhe shëndetin, i ekspozohen rrezikut në mënyrë permanente dhe të befasishme. Situata të tilla paraqiten në baza ditore rastet si: gjatë përgjigjes në thirrjet e qytetarëve për ndihmë dhe ofrim të shërbimeve; kontrolli dhe sigurimi i kufirit shtetëror; intervenimit dhe reagimit në rastet e krimeve dhe incidenteve të ndryshme; fatkeqësive natyrore; aksidenteve në trafik; ballafaqimi me trazira dhe prishje të rendit dhe sigurisë publike në përmasa të mëdha; arrestimin dhe transportin e personave me rrezikshmëri; zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit; luftimi i krimit përfshirë por pa u kufizuar vetëm në krimin e organizuar, terrorizmin, narkotikë, kontrabandës me armë dhe mallra, trafikimin me qenie njerëzore; kërkimi dhe arrestimi i personave të arratisur; gjurmimi dhe zbulimi i materive helmuese dhe eksplozive por edhe trajtimi i materieve të tilla; shpëtimi i pengjeve; rastet e kidnapimit; goditja e grupeve kriminale të organizuara; kërcënimeve me armë dhe materie tjera eksplozive; bazuar në dispozitat ligjore zyrtari policorë, në të gjitha rrethanat, kur e takon një incident në progres ka obligim ligjor 24/7 orë të ndërhyjë dhe t'a menaxhoj incidentin pavarësisht nivelit të rrezikut për jetën e tij, etj.

## **II. NENIN 35 DHE 36 KOMPENSIMET; KOMPENSIMI PËR KUJDESTARI, PUNËN GJATË NATËS DHE JASHTË ORARIT TË PUNËS**

Në kuadër të ligjit për paga në nenin 35 dhe në nenin 36 janë paraparë llojet e kompensimeve kur zyrtarët përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën me kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë si dhe punën në ditët e festave zyrtare.

Në nenin 36 Parografi 1 të Ligjit për Paga përcaktohet: “*Zyrtaret/ët publik/e dhe kategoritë e tjera të të punësuarave/ëve që paguhën nga buxheti i shtetit, përjashtimisht funksionareve/ëve publik/e përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën me kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë, punën në ditët e festave zyrtare*”.

Në bazë të kësaj është përcaktuar se fillimisht zyrtari do të duhej të kompensohet në aspektin financier respektivisht në vlerë monetare dhe pastaj me pushim në rastet të caktuara. Nga llogaritjet e bëra ne kemi vlerësuar se në këtë rast dispozita do të duhej më shumë të zbatohet duke kompensuar më shumë stafin me pushim sesa me vlerë monetare për shkak të shumës së përcaktuar për këtë kategori të shtesës. Kjo për faktin se shuma e paraparë të ndahet për këtë qëllim është qartësisht e dallueshme se nuk mund të zbatohet në raport me numrin e madh të zyrtarëve policor të cilët angazhohen në aktivitetet të cilat janë të parapara të kompensohen. Sipas mendimit tonë qëllimi i normës duket i qartë dhe ai është kompensimi me vlerë monetare si parim dhe në rastet tjera si përjashtim kompensimi me pushim dhe jo e kundërtë. Në rastin e Policisë kjo nuk do të mund të jetë e zbatueshme sipas këtij parim apo prioriteti për shkak të përqindjes së ulët të kësaj shtese në raport me nevojat.

Në paragrafin 4 të nenit 36 është paraparë kufizimit i vlerës totale të kompensimit për punën shtesë nga orari i rregullt. Kjo shumë nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore në kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe Shtesa” të atij viti fiskal.

Për të ilustruar këtë nga përllogaritjet tona në kuadër të buxhetit për vitin 2022, pjesëmarria e kompensimit (puna jashtë orarit, ndërrimet e natës dhe kompensimet tjera) në Polici shprehur në vlerë monetare ishte **12,204,059.41 euro apo në përqindje 15.05% e vlerës së buxhetit të Policisë**. Në bazë të Ligjit të Ri për paga kjo shumë është **1% apo rreth 838 000** ( tetëqind e tridhjetë e tetë mijë euro). Kjo shumë është lehtë e kalkulueshme sepse në Buxhetin e vitit 2023 për kategorinë e pagave dhe shtesave për Policinë e Kosovës janë ndarë gjithsejtë **83,894,606.00 euro**

Më konkretisht gjatë vitit 2022 në kuadër të kompensimeve tjera në Polici janë shpenzuar:

- punë jashtë orarit janë shpenzuar: **7,218,271.27 euro;**
- për punë me ndërrime- ndërrimi i natës **1,680,703.41 euro;**
- punë sekondare **2,990,003.09 euro** ( fondi i mjeteve për punë sekondare është ne kuadër të kategorisë së pagave dhe mëditjeve)
- Shpërbimi për Përvojë të punës **122,037.80 euro**
- Kompensim për vdekjen e një anëtarë **193,043.84 euro**

Gjithsejtë kompensimet për vitin 2022 në Polici është **12,2047,059.41 euro**

Sic shihet nga të dhënat më lartë tek kategoria e kompensimeve në Polici gjatë vitit 2022 vetëm për punën jashtë orarit janë ndarë rreth **9%** të buxhetit të PK-së dhe gjithashtu vetëm për **ndërrimin e natës janë shpenzuar rreth 1.68 milion euro apo 2.10%** e buxhetit të PK-së. Nga kjo shihet qartë se zbatimi i dispozitave të nenit 36 të Ligjit të Pagave nënkuption pamundësinë e kompensimit madje vetëm të punës gjatë natës për personelin policor.

Në kuadër të legjisacionit të aplikueshëm në Kosovë kjo është paraparë edhe në ligje tjera. Kjo konsiderojmë se është njëjtë e rregulluar edhe në Ligjin i Punës Nr. 03/L-212. Më konkretisht ky ligj në Nenin 56 paragrafi 1 përcakton ' *Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës*'. Për më shumë Ligji i Punës ka paraparë rastet ku i punësuari për punë jashtë orarit, gjatë festave, punën natën ka të drejtë në pagë shtesë. E drejta e kompensimit me pushim e këtyre kategorive në Ligjin e Punës në nenin 56 paragrafi 4 është përcaktuar se mund të bëhet me kërkesë të punësuarit respektivisht në paragrin 5 " *Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrin 2...*" . Sipas rregullimit të paraparë në Ligjin e Punës puna shtesë jashtë orarit nga punëdhënësi mund të kompensohet me ditë pushimi dhe kjo nuk nënkupton edhe kompensimin e punës gjatë natës si orar i rregullt.

Për më shumë konsiderojmë se ky rregullim është në kundërshtim edhe me vet përkufizimet e parapara në Ligjin për Paga, konkretisht Neni 3. Neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8. përcakton se: " *kompensim - nënkupton pagesën në formën e mbulimit të shpenzinive të kryera apo që do të kryhen nga e/i punësuara/i, për udhëtime, qëndrim apo përfaqësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, apo kompensi për punë gjatë natës, jashtë orarit të punës dhe kompensimi për kujdestari*". Gjithashtu në 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 përcaktohet : " *shtesë page apo shtesë - nënkupton komponentin e pagës që i shtohet pagës bazë dhe që synon të shpërbilejë punën për kushte të vështira, sektorë apo specializime të veçanta dhe që nuk shpërbilehet nga paga bazë. Shtesa e pagës mund të jetë e rregullt, kur përfitohet për çdo muaj apo e parregullt kur shpërbilehet sipas rastit në bazë të këtij ligji*" Nga përkufizimet e dhëna me këtë ligj është e qartë se kompensimi mendohet fillimi shtesë jo kompensim me pushim.

Ne konsiderojmë se kjo duhet të vlerësohet nëse Ligji nuk është në harmoni me Kushtetutën. Kjo përkundër faktit se me dispozitë është paraparë si e drejtë e të punësuarit kompensimi monetar në aspekti praktik një dispozitë e tillë nuk mund të zbatohet. Gjithashtu konsiderojmë se mund të këtë

hapësirë për interpretime të ndryshme cili kriter do të vlejë si parim apo prioritet, kompensimi me vlerë monetare dhe si dytësore kompensimi me ditë pushimi apo e kundërtë. Nëse në rastin tonë është praktikisht do të duhej të zbatohej norma në atë mënyrë që zyrtarët do të kompensohen në masën më të madhe me pushim sësa me kompensim material mendojmë se cenon të drejtat e të punësuarve të garantuar me Kushtetutë.

### III. NENI 44 SHTOJCAT E LIGJIT, SHTOJCA NR.5.1. – POLICIA E KOSOVËS;

Përcaktimi i grupit, klasave dhe koeficienteve është bërë në bazë të parimit në bazë të ekuivalencës. Ky përcaktim është bërë duke marrë për bazë funksionet e ngjashme apo të njëjta. Në kuadër të Ligjit Neni 3 Përkufizimet, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 përcaktohet se “*funksion i ngjashëm – nënkupton një funksion të të njëjtit lloj apo pothuajse të njëjtë, brenda të njëjtës organizatë buxhetore ose në një organizatë tjetër buxhetore, që përfshin të njëjtat kushte të arsimit, nivelin e përgjegjësisë, kompleksitetin dhe kushtet e punës*”

Ne konsiderojmë se vlerësimi i Klasës dhe Koeficientit të Policisë nuk është bërë në mënyrë të drejtë krahasuar me funksionet e ngjashme në institucione tjera. Për tu siguruar trajtimi i barabartë dhe i drejtë kategorizimi i personelit policor duhet të shikohet në raport me ato institucione ku është e mundur krahasimi siç janë Institucionet e Zbatimit të Ligjit dhe ato të Sigurisë. Nga këndvështrimi i natyrës së punës dhe kushteve të punës, konsiderojmë se Policia është e rëndësishme të kategorizohet drejt për aq sa është e mundur në raport me Institucionet tjera. Trajtim ndryshtë vërehet në Forcën e Sigurisë, Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), Doganën, Njësinë e Inteligjencës Financiare –NJIF, hetues/operativ në AKK etj.

Në aspektin e pozitave specifike të veçanta dallimi është shumë i madh në rastin e krahasimit të zyrtarëve policor me pozitat e hetuesit të IPK-së, zyrtarëve të doganës, ekspert në prokurori etj. Saktësishët zyrtarët policor kryejnë edhe detyra të hetuesit madje hetime shume më komplekse sësa në institucionet tjera si dhe ka zyrtar policor në cilësi të ekspertit të cilët kryejnë gjithashtu ekspertiza për Prokurorinë. Pozita të tillë në Polici në disa fusha janë edhe më komplekse shembull: pozitat e hetuesit në krimë kibernetike; hetuesit e krimit të organizuar; hetuesit e krimit ekonomik dhe korruptionit; zyrtar policor i inteligjencës; hetuesit e veprave penale të terrorizimit; zyrtari policor si agjent i mbuluar; trajtues i informatorëve, zyrtari policor ekspert financiar etj. Zyrtari Policor- Polic i lartë i cili mund të jetë hetues në bazë të projektligjit të propozuar ka koeficientin 5.9, gjersa hetuesi në IPK (inspektor me autorizime policore) ka koeficientin 7.5 ; zyrtari hetues/operativ në AKK ka koeficientin 9.4 dhe kryesishët merret me hetime të nivelit ku kërkohet ekspertizë më e ulët sësa e hetuesit të Policisë. Në doganë zyrtari doganor i nivelit të katërt ka koeficientin 9.4, zyrtar doganor niveli të tretë 7.8, zyrtarë doganor niveli i dytë 7.3 dhe zyrtar doganor niveli i parë 6.5. Në Njësinë e Inteligjencës Financiare analisti i inteligjencës ( profesional 1) ka koeficientin 9, analisti i inteligjencës i ri (profesional 2) ka koeficientin 7.2. Në Polici shumica e analistëve të inteligjencës kanë gradën Polic i lartë do të thotë koeficientin 5.9.

Në kuadër të Institucioneve të Kosovës sa iu përket gradave krahasimi më i përafërt mund të bëhet me Forcën e Sigurisë së Kosovës- (FSK). Nëse krahasohen Tabelat Nr. 5 Policia e Kosovës dhe Tabela Nr. 4 Forca e Sigurisë së Kosovës vërehet dallim i konsiderueshëm i trajtimit të pabarabartë të gradave.

Ky dallim është i theksuar nga niveli më i ulët deri tek niveli më i lartë. Në tabelën në vazhdim janë bërë krahasimet e gradave në Polici dhe në ato të FSK-së dhe dallimet në koeficient tek stafi i uniformuar është shumë i madh dhe sidomos pasur parasysh kompleksitetin dhe natyrën e punës policore.

Tabela krahasimi PK & FSK sipas Ligjit për pagë			
Gradat PK	Koeficienti PK	Koeficienti FSK	Gradat FSK
Drejtor i Përgjithshëm	14.5	15	Komandanti FSK
Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm	12.8	14.5	Gjenerallejtënant
Drejtor i Departamentit	11.2	14	Gjeneralmajor
Drejtor i Departamentit	11.2	13	Gjeneral Brigade
Kolonel	10.2	12	Kolonel
N/Kolonel	9.2	11	N/Kolonel
Major	8.2	10	Major
Kapiten	7.4	9	Kapiten
Toger	7	8.2	Toger
Rreshter	6.4	8.2	Rreshter i Parë
Polic lartë	5.9	6.1	Tetar
Polic	5	5.8	Ushtar i Klasit të parë
Polic i ri	4.5	5.6	Ushtar
Kadet policor	2	2	Kadet

Dallimi në mes gradave është i ndryshëm jo në mënyrë proporcionale sipas nivelit në mes të gradave por edhe gradat me emërtime të njëjta.

#### Propozimi V:

**Shtoja Nr. 10.6. - e Projektligjit - nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësi i administratës së shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës.**

Në kuadër të kësaj kategorie përfshirë pozitat Profesional 1, Profesional 2 dhe Profesional 3 për shkak të specifikave, natyrës së punës te stafi i Policisë në këto pozita vërehen dallime sa i përket kategorizimit në raport me institucionet tjera. Në këtë kontekst ne mendojmë se stafi në kuadër të Policisë duhet të jetë i ranguar në nivelin e njëjtë me stafin e Institucioneve tjera shembull Gjykatës dhe Prokurorisë dhe institucioneve tjera sepse kryejnë detyra të njëjta dhe kompleksiteti i detyrave dhe përgjegjësive që kanë në Polici mund të jetë shumë më i lartë se në shumë institucione.

Gjithashtu tek stafi i kategorisë Nëpunës teknik dhe mbështetës 3 ku hyjnë shumë personel i Policisë janë kategori unike dhe veçanta të cilat i ka vetëm policia dhe nuk kanë ndonjë krahasim me institucionet tjera siç janë pozitat: Mekanik i Armëve ; Autoelektricist; Autolimarë; Automekanik; Elektricist; Mekanik; Moler (Teknik i ngjyrosjes); Murator (Teknik i ndërtimit); Teknik i Elektros për Gjenerator; Teknik i Makinerisë për Gjenerator; Teknik i ngrohjes qendrore; Teknik i Zdrukthtarisë; Ujëinstalues; Zdrukthtar; Autolarës etj. Këtyre pozitave i është caktuar koeficienti 3.76 dhe në bazë të krahasimit me pagat aktuale kemi zbritje të pagës. Mendojmë se këto pozita nuk mund të krahasohen me pozita tjera të ngjashme në institucionet tjera sepse shumica janë specifike për Policinë prandaj edhe ulja e koeficientit për to mendojmë se nuk ka bazë legale të arsyeshme.

Mbështetur në faktet e prezantuara në këtë shkresë ne vlerësojmë se veprimi i Avokatit të Popullit është i domosdoshëm që në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore t'i analizojë, vlerësoj por edhe t'i adresojë tutje shqetësimet, vërejtjet e Sindikatës së Policisë së Kosovës në raport me dyshimet që kemi për kushtetutshmërinë e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

Me respekt:

z.Imer Zeqiri

Kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës

